

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

## TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 02 TETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 02. OKTOBARA 2003.G.

Tetor - Oktobar  
2003



**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e financave publike (2003/25),
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet (2003/26).

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о измени и допуни Закона о менаџирању јавним финансијама (2003/25),
3. Прво разматрање Нацрта закона о пестицидима (2003/26).

**AGENDA**

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on changing and completing of the Law on Management of Public Finance (2003/25),
3. First reading of the Draft Law on aw on pesticide (2003/26).

## T R A N S K R I P T

### I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 02 TETOR 2003

Seanca Plenare u mbajt në sallën e Kuvendit të Prishtinës.

**SEANCËN E KRYESOI, AKADEMİK NEXHAT DACI,  
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYYESUES, XHAVIT HALITI, ANËTAR I  
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi punën në orën 10,00.

**KRYETARI NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes kolegë deputetë,

Më lejoni që t'ju dëshiroj mirëseardhje juve dhe, në veçanti, kryeministrin dhe kabinetin të tij, në punën e Seancës së sotme të rregullt plenare.

Të gjitha materialet ju janë shpërndarë me kohë. Besoj se telefonat celular i keni ç'kyçur dhe kjo vlenë veçanërisht për Ivanoviqin se nuk i duhen kontaktet sot me Beogradin, por me Kosovën. Prandaj, jemi në një ditë të mirë, jemi të përgatitur dhe besoj se miratimi i Procesverbalit është punë rutinore dhe në qoftë se ndokush ka vërejtje, mund t'i bëjë me shkrim.

Unë do t'ju lutja për vëmendje dhe qetësi, si gjithmonë.

Para se të kalojmë në pikën e dytë, do të doja t'ju informoj për kontaktet shumintensive lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Përveç kësaj, do t'ju them se kanë arritur edhe dy shkresa: një shkresë nga zoti Sollana, që është emituar në media dhe është e nënshkruar dhe, do të thoja, është një letër e mirë, por është edhe një shrkesë për të cilën, unë ndiej obligim t'ju njoftoj, edhe pse nuk është thënë decidivisht... E kam një shkresë nga Grupi i Kontaktit, dje pasdite, në të cilën është përmbajtja e njëjtë: kërkohet sjellje e përgjegjshme e përfaqësuesve në institacione. Përkujtohet se ne kemi marrë obligimet në Samitin e Selanikut në qershori dhe në një mënyrë shpjegoitet ajo që mediat e kanë patur. Edhe bisedat tjera telefonike janë të këtij niveli dhe të kësaj përmbajtjeje.

Prandaj, pa humbur kohë, që të kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me marrjen e qëndrimit për bisedimet e mundshme Kosovë – unioni Serbi Mali i zi.

Ftoj kryeministrin e Kosovës ose personin, nëse e ka autorizuar ndokë tjetër për këtë që të marrë fjalën.

Zoti kryeministër foltorja është e juaja.

#### BAJRAM REXHEPI:

I nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë,

Dialogun me Serbinë, si një nga tetë standartet nga ish kryeadministratori Shtajner dhe të përkrahura nga institucionet relevante ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës nuk e ka nënçmuar asnjëherë, por as nuk e ka përdimensionuar. Kjo çështje, disaherë, është trajtuar në Qeveri në mënyrë që, nëse vjen deri te dialogu, të jemi sa më të përgatitur.

Me të drejtë kemi kërkuar vazhdimisht që të transferohen sa më tepër kompetenca në Qeveri, që të shtohet funksionaliteti dhe efikasiteti karshi pritjeve reale të qytetarëve të Kosovës, përbushjes së standardeve, e në kuadër të tyre, edhe të dialogut, gjithashtu. Në këtë aspekt, deri më tanë, kemi hasë në mosgatishmërinë nga ana e UNMIK-ut.